



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

9 Korrik 2014, Prizren/Prishtinë

VENDIM

I Komisionit Vlerësues për aplikimet që i janë përgjigjur thirrjes publike për propozime
“Ide kreative për intervenimeve artistike në Prizren”

Komisioni Vlerësues për vlerësimin dhe përzgjedhjen e intervenimeve artistike në Prizren është themeluar me vendimin e datës 1 korrik 2014 dhe ka këtë përbërje: Rozafa Basha nga EC Ma Ndryshe, Veton Nurkollari nga Dokufest dhe Jeffrey Jamison nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. Komisioni Vlerësues është takuar më 9 korrik 2014 në zyret e EC Ma Ndryshe në Prishtinë dhe i ka shqyrtuar të gjitha aplikimet që i janë përgjigjur thirrjes publike për propozime “Ide kreative për intervenimeve artistike në Prizren”.

Në vlerësimin e aplikimeve, Komisioni Vlerësues ka përdorur sistemin (tabelën) e vlerësimit duke iu përgjigjur pyetjeve në pesë seksione: 1. Aplikacioni, 2. Përputhshmëria me objektivat e projektit, 3. Relevanca e intervenimit, 4. Efektiviteti, realizueshmëria dhe qëndrueshmëria e intervenimit dhe 5. Buxheti i intervenimit. Anëtarët e Komisionit kanë patur të drejtë që të ofrojnë vlerësim shtesë në pikën 6 të tabelës së vlerësimit.

Pas vlerësimit të të gjitha aplikimeve, dhe në bazë të numrit më të madh të pikëve, Komisioni Vlerësues shpall fitues këto tri ide kreative për intervenime artistike në Prizren.

Renditja	Titulli i intervenimit	Autori bartës	Numri i pikëve	Sugjerime shtesë
Vendi i parë	I am a monument	Senat Haliti	63.7	1. Tabela informative dhe fotot e vjetra 2. Sllogane që ndryshojnë
Vendi i dytë	Analogjia inverse	Nora Temaj	59	1. Përdorimi i materialeve të reciklueshme 2. Tabela informative
Vendi i tretë	Love bridge - Artasta	Doruntina Ukimeri	49	1. Zgjedhja e një ure tjetër

Secila nga keto tri idetë fituese do të përkrahen me nga 1000 USD (njëmijë dollarë amerikanë) për realizimin dhe ekzekutimin e intervenimeve artistike në hapësirën publike, në kuadër të projektit “Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren”, që përkrahet financiarisht nga Ambasada Amerikane në Prishtinë.


Në tabelën e mëposhtme janë të renditura të gjitha idetë që nuk janë përzgjedhur për përkrahje nga kjo thirrje. Renditja është në bazë të pikëve të marra nga Komisioni Vlerësues. Për shkak të pamundësisë financiare për të përkrahur të gjitha aplikimet dhe duke u bazuar në cilësinë e ideve në tabelën e mëposhtme, EC Ma Ndryshe zotohet që bashkë me autorët që nuk janë përzgjedhur për përkrahje në këtë thirrje, të angazhohet në gjetjen e mundësive të tjera për realizimin e këtyre ideve/intervenimeve.

Renditja	Titulli i intervenimit	Autori bartës	Numri i pikëve
Vendi i katërt	Merula për të gjithë!	Isen Bobaj	47.7
Vendi i pestë	Back to the ottomans	Korab Krasniqi	36
Vendi i gjashtë	Harmonia e lojës	Sead Kazanxhiu	31.7
Vendi i shtatë	Ura e misionit të dashurisë	Fatlum Kryeziu	25.33
Vendi i tetë	My way	Lulzim Zeqiri	23
Vendi i nëntë	Me pa prej një pike	Leutrim Fishekqiu	21.7
Vendi i dhjetë	Dance to forget...	Qëndresë Deda	20.33
Vendi i njëmbëdhjetë	Urban furniture	Recep Kerkez	15.7
Vendi i dymbëdhjetë	Harku i triumfit i Prizrenit	Visar Grajçevci	14
Vendi i trembëdhjetë	Nuk ka formë aplikimi	Enis Shatri	N/A


Ky vendim i Komisionit Vlerësues është përfundimtar dhe e autorizon organizatën EC Ma Ndryshe për t'i shpallur rezultatet e vlerësimit dhe për t'i kontaktuar autorët fitues për t'i negociuar të gjitha detajet e realizimit të intervenimeve artistike.

9 korrik 2014, Prizren/Prishtinë

Anëtarët e Komisionit Vlerësues


Rozafa Basha
EC Ma Ndryshe


Veton Nurkollari
Dokufest


Jeffrey Jamison
Ambasada Amerikane

Projekti "Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren" financohet përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë.

